

**Njoftim për përqendrim me të cilin Telekom Serbia SHA, Serbi fiton një pjesë të
biznesit të United Media
(lënda nr. 08-39/2025)**

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16, 83/18 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 208/24 dhe 16/25), më datë 19.02.2025, dhe plotësuar më 21.02.2025 dhe 28.02.2025, Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës i është dorëzuar njoftim për përqendrim me të cilin Ndërmarrja për telekomunikacion Telekom Serbia shoqëri aksionare, Beograd me seli në Takovska nr. 2, Beograd, Serbi do të marrë biznesin direct-to-home të Serbia Broadband - Srpske Kablovske Mreze d.o.o. Beograd në Serbi dhe Maqedoninë e Veriut.

Konkretisht, Telekom Serbia sh.a. do të fitojë pronën, kontratat dhe të drejtat që Serbia Broadband - Srpske Kablovske Mreze d.o.o. i përdor në lidhje me Biznesin e saj të Synuar në Serbi.

Lidhur me pronën relevante në Maqedoninë e Veriut, Telekom Serbia sh.a. do të fitojë shoqërinë Adria DTH B.V. Amsterdam dhe filialin e saj TOTAL TV SHPK Shkup.

Përveç kësaj, Telekom Serbia sh.a. do të fitojë nga kompanitë e lidhura të shoqërisë United Group si vijon:

1. 100% të pjesëmarrjes në shoqërinë EON TV International, me seli në Nikozi 2415, Qipro ("EON"), rruga Emmanouil Xanthou 13, Makedonitissa, e cila menaxhon NetTV Plus, një shërbim OTT streaming të destinuar për diasporën nga ish-Jugosllavia në mbarë botën dhe
2. 100% të pjesëmarrjes në shoqërinë SportCo d.o.o. Beograd, me seli në Beograd, rr. Kneza Visislava 88, që përfshin të drejta të caktuara për shpërndarjen e përmbajtjes dhe kanaleve që aktualisht i shpërndan njësia e biznesit "Sport Klub" në Maqedoninë e Veriut, Bosnjë dhe Hercegovinë, Mal të Zi dhe Serbi.

Personi i lidhur me Parashtruesin e njoftimit në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut:

Personi i lidhur me Telekom Serbia sh.a. në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut është Shoqëria për tregti dhe shërbime MTEL SHPKNJP Shkup, me seli në rrugën "Maksim Gorki" 11/1-3, Shkup, Qendër, në Republikën e Maqedonisë së Veriut, e regjistruar për veprimtarinë e telekomunikacioneve me tela (kodi i veprimtarisë 61.10), përkatësisht për ofrimin e shërbimeve për qasje publike radio-telefonike në rrjetin publik telefonik, rrjetin publik të komunikimit mobil, ritransmetimin e shërbimeve për programin televiziv dhe shërbimet satelitore.

Personi i lidhur me MTEL SHPKNJP Shkup është Shoqëria për telekomunikacion LIKEMOBILE SHPKNJP Shkup selia e së cilës është e regjistruar në rrugën "Maksim Gorki" 11/1-3, Shkup, Qendër, në Republikën e Maqedonisë së Veriut, e regjistruar për veprimtarinë e telekomunikacioneve pa tela (kodi i veprimtarisë 61.20). Shoqëria për telekomunikacion LIKEMOBILE SHPKNJP Shkup vepron në tregun e ofrimit të shërbimeve mobile të komunikimeve elektronike (shërbim me parapagesë-pripeid) dhe nuk u ofron përdoruesve të saj përfundimtarë shërbim mobil postpaid- mujore. Shoqëria për telekomunikacion LIKEMOBILE SHPKNJP Shkup është operator virtual i rrjetit mobil (MVNO) në tregun

maqedonas të komunikimeve elektronike dhe ofron shërbime kombëtare, ndërkombëtare dhe roaming të zërit, SMS-ve dhe internetit.

Personi i lidhur me Shoqëritë e Synuara në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut:

Personi i lidhur me Shoqëritë e Synuara në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut është Shoqëria për tregti dhe shërbime TOTAL TV SHPK Shkup ("TOTAL TV SHPK Shkup"), me seli në Bulevardin Partizanski Odredi nr. 17, 1-001/Shkup - Qendër, Qendër, në Republikën e Maqedonisë së Veriut, e regjistruar për veprimtarinë - telekomunikacione satelitore.

Parashtruesi i njoftimit propozon që si tregje relevante për vlerësimin e përqendrimit në fjalë të përcaktohen: tregu i ofrimit të shërbimeve me pakicë për shpërndarjen e përmbajtjeve mediatike dhe tregu i prodhimit dhe transmetimit të programit televiziv.

Bazuar në shqyrtimin paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.

Komisioni fton palët e treta të interesuara të paraqesin vërejtje dhe mendime për këtë përqendrim te Komisioni. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuara mund të dërgohen në adresën: rr. "Shën Kirili dhe Metodi" nr. 54, Shkup ose me e-mail: kzk@kzk.gov.mk dhe duhet të arrijnë në Komision brenda 10 ditëve nga data e publikimit të këtij njoftimi.

04.03.2025

Shkup